




REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVA

KOMISIONI I PAVARUR I MEDIAVE
NEZAVISNA KOMISIJA ZA MEDIJE
INDEPENDENT MEDIA COMMISSION



“ISP BROADCAST” SH.P.K.
Numri i biznesit – 810011643
Pronar– Qëndrim KRYEZIU
OSHMA “ARB Max”
Rr/24 Maji, nr. 46-1
Prishtinë



VENDIM

për licencimin e Ofruesit të Shërbimeve Mediale Adiovizuale “ARB Max” për transmetim përmes operatorëve të shpërndarjes – me seli në Prishtinë

Faktet

1. Komisioni i Pavarur për Media (KPM), në bazë të nenit 3, paragrafi 2.6. të ligjit për KPM (Ligji nr. 04/L-44), nxjerr akte nënligjore për rregullimin e transmetimit dhe të shërbimeve mediale audiovizuale, të cilat nevojiten për të kryer funksionet e saj në pajtim me standardet ndërkombëtare.
2. Rregullorja për Ofruesit e Shërbimeve Mediale Audio dhe Audiovizuale KPM-2017/02, ka hyrë në fuqi më 25 janar 2017, ndërsa, me Kreun III të kësaj rregulloreje, KPM ka krijuar bazën ligjore për licencimin e Ofruesve të Shërbimeve Audio dhe Audiovizuale të cilët transmetojnë përmes operatorëve të shpërndarjes, e që do të kenë mundësi të prodhojnë programe përmbajtjesore dhe t'i transmetojnë ato përmes cilit do operator të shpërndarjes.
3. Më datën 09 shkurt 2023, kandidati “ARB Max”, ka parashtruar aplikacionin për licencë të KPM-së për të vepruar si ofrues të shërbimeve mediale audiovizuale (OSHMA) për transmetim përmes operatorit të shpërndarjes.
4. Për shkak të mungesës së kuorumit për vendimmarrje të Komisionit të Pavarur të Mediave, nga data 15 tetor 2022 deri më datën 6 qershor 2023, kërkesa e kandidatit “ARB Max”, nuk ka arritur të shqyrtohet me kohë.

Arsyetim

5. Komisioni vlerëson se, kandidati për licencë të KPM-së OSHMA “ARB Max”, në aplikacionin e tij ka paraqitur të dhënat e nevojshme për Licencë të KPM-së dhe në pajtueshmëri me Rregulloren KPM-2021/01.
6. Biznesi ISP Broadcast SH.P.K. si kandidat për licencë të OSHMA “ARB Max”, posedon licencë të KPM-së për operator të shpërndarjes.
7. Komisioni vlerëson se, kandidati për licencë të KPM-së “ARB Max” ka ofruar të dhënat e mjaftueshme për vlerësim të aplikacionit. Materialet e ofruara si pjesë e aplikacionit konsiderohen të qëndrueshme, përfshirë skemën programore, të dhënat rreth aftësive profesionale dhe menaxheriale për të udhëhequr me ofrues të shërbimeve mediale audiovizuale, si dhe të dhënat rreth qëndrueshmërisë financiare.
8. Komisioni konstaton se biznesi ISP Broadcast SH.P.K, ka shlyer obligimet financiare ndaj KPM-së.
9. Sipas Nenit 15, paragrafit 5 të Rregullores KPM-2021/01, kandidati për licencë të KPM-së “ARB Max”, duhet të veprojë në pajtueshmëri me të gjitha rregullat dhe aktet tjera nënligjore të nxjerra nga KPM, në pajtueshmëri me Ligjin e KPM-së, si dhe me ligjet tjera të zbatueshme në Republikën e Kosovës.
10. Komisioni vlerëson se, kandidati “ARB Max” ka përmbushur kriteret kualifikuese për t’u pajisur me licencë të KPM-së për ofrues të shërbimeve mediale audiovizuale, në pajtim me Rregulloren KPM-2021/01.

Vendim

11. Komisioni në takimin e datës 17 korrik 2023, vendos që kandidatit “ARB Max”, me seli në Prishtinë, t’i lëshoj licencën për të vepruar si Ofrues i Shërbimeve Mediale Audiovizuale me transmetim përmes operatorëve të shpërndarjes në Republikën e Kosovës.
12. Këtë vendim e lëshon Komisioni dhe i njëjti hyn në fuqi nga data e nënshkrimit.



Jeton Mehmeti

Kryetar

Komisioni i Pavarur i Mediave



17.07.2023

Data